



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**  
**REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA E DEÇANIT**  
**MUNICIPALITY OF DEÇAN**  
**OPSTINA DEÇAN**



Drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër  
12- Zyrtarisht /2026  
Deçan, 15.01.2026



Për: Kryetarin e Komunës së Deçanit Z. Bashkim Ramosaj

Përmes: Drejtorit të Drejtorisë Z. Agron Mustiftaj

Nga: UD Shefi i Drejtorisë Z. Muhamet Avdiqaj

Lënda: Raport Pune për periudhën 04 Janar 2025 – 31 Dhjetor 2025,  
Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e  
Deçanit.



Së bashku me këtë shkresë do gjeni edhe Raportin e punës për periudhë 04.01.2025 – 31.12.2025 për Drejtorinë e  
Gjeodezisë dhe Kadastrit në Deçan.

# R A P O R T P U N E

*Për periudhën 04.01. 2025– 31.12.2025 i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Degan*

## 1. Shefi i Sherbimit njëkohësisht edhe zyrtari për RDPP së bashku me referentin e ndryshimeve kadastrale

Gjatë periudhës për të cilën po raportojmë përkatësisht prej fillimit të vitit 2025 e deri me datën e përpilimit të këtij raporti , Zyrtari për RDPP ka pranuar gjithsej 759 kërkesa nga palë të ndryshme për realizimin e të drejtave ligjore që dalin nga Regjistrimi i të Drejtave në Pronën e Paluajtshme (RDPP).

Nga të gjitha këto kërkesa deri me tani janë shqyrtuar 730 dhe për të njëjtat janë lëshuar aktvendime adekuatë me të cilat palëve iu është njohur e drejta ligjore e kërkuar ose ju ka refuzuar e njëjta kërkesë dhe ju ka dhënë e drejta e ankesës në organin e shkallës së dytë. Ndërsa 29 kërkesa janë në procedurë e sipër.

Aktvendimet me të cilat palës i është njohur e drejta në RDPP, në afat ligjor dërgohen te referenti për ndryshime kadastrale i cili konform këtyre vendimeve bënë azhurimin në librat përkatës të elaboratit kadastral dhe të njëjta prapë i azhurnon duke i futur të dhënat në kompjuter përkatësisht në programin e SIKTK-së

Krahas këtyre punëve Zyrtari për RDPP i cili i kryen edhe detyrat e shefit të shërbimit ka kryer edhe punë tjera nga lëmi i shërbimeve pronësore juridike si dhe së bashku me Referentin për ndryshime kadastrale kanë kryer edhe punë tjera me urdhër të drejtorit .

## 2. Zyrtarët e mirëmbajtjes së Kadastrit

Në këtë sektor punojnë tre zyrtar për mirëmbajtjen e Kadastrit

Këta zyrtar gjatë periudhës raportuese i kanë pasur **456** azhurime të lëndëve nga tereni sipas kërkesë së palëve siç janë : Ndarja e parcelave, Bashkimi i parcelave, Regjistrimi i Objekteve, korrigjimi i sipërfaqeve, korrigjimi i mexhave dhe fuqja e të dhënave të reja në sistemin e tyre. Këto lëndë të gjitha janë zgjedhur me përfundim të **12** rasteve të cilat ende janë në procedurë e sipër. Gjithashtu këta zyrtar gjatë kësaj periudhe kanë lëshuar **11** historiate dhe identifikime të mexhave sipas kërkesave të palëve dhe kanë lëshuar **850** kopje plani.

## 3. Referenti për pranimin e palëve

Gjatë periudhës për të cilën raportojmë, referenti për pranimin e palëve ka pranuar gjithsej **3046** kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me dhënie e certifikatave të pronës së paluajtshme, kopjeve të planit dhe vërtetimeve me të cilat vërtetohet se a ka apo nuk ka pala pasuri të paluajtshme, në territorin e Komunës.

I njëjti zyrtar i ka proceduar të gjitha këto kërkesa dhe për secilën kërkesë palët janë pajisur me dokumente përkatëse në afatin brenda ditës së paraqitjes së kërkesës. I njëjti punëtor krahas këtyre punëve ka kryer edhe punët e përpunuesit në SIK TK. Gjithsejt lëndë të kryera nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadashter deri ne përpilimin e këti raportit janë **5122** lëndë të ndryshme.

Kjo Drejtori krahos këtyre punëve të evidentuara më lartë ka kryer edhe punë tjera të parashtruara konform  
kërkesave të palëve private dhe organeve komunale.

Raportin e përpiloi :  
UD Shefi i kësaj Drejtorie  
Muhamet Avdiqaj



D r e j t o r i  
Agron Mustijaj

